


Mejrukshe

MBËSHTJELLËSI I LËNDËS

Shtojca 11 – Mbështjellësi i Lëndës

01-1336

30.06.2021



Akti – lënda vendoset në a.a.

Shenja e klasifikimit

Lënda : Ankese

Alltn Murseli (Banorët e lagjes Tringë Smajli)

Lëndët e zgjidhura njëkohësisht nr.

Numri i ruajtur dhe afati i ruajtjes

Numri nga libri intern i dorëzimit 1461

Afati:

Zgjidhja e lëndës:

aprovim / refuzim

01-879/21


Data:/...../.....

E përpunoi :

.....
vendi

.....

KOMUNËS SË PRISHTINËS
- DRGJTORIS SE URBANIZIMIT



Lënda: përgjigje / koment në njoftimin publik të datës 16.06.2021.

Më datën 16.06.2021. keni shpallur njoftimin publik duke na informuar se në Komunën e Prishtinës është dorëzuar **kërkesa nr.05-350/02-78983/21** e datës 05.05.2021. e pronarit Besnik Asllani, përmes së cilës kërkohet përcaktimi i kriterëve të caktuara për ndërtimin e ndërtesës banimore-afariste, me etazhitet 2B+P+5, në parcelat kadastrale nr.6528 dhe 6529 ZK Prishtinë, në kuadër të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU.

Njëkohësisht jemi njoftuar se komentet tona mund t'i dorëzojmë deri më datën 01.07.2021.

Ne jemi banorët e ndërtesës banimore në rrugën Tringë Smajli nr.72, e cila gjendet në kufirin e ngastrave kadastrale të cekura më lartë,

Shprehim pakënaqësinë dhe mospajtimin e fuqishëm me këtë ndërtim dhe kërkojmë që parashtruesit të kërkesës të mos t'i lejohet ndërtimi.

Lokacioni në të cilin kërkohet ndërtimi është më së shumti 10 m larg ndërtesës ton. Këndi i ndërtesës ton është tërësisht i ngjitur me këtë lokacion, pra ka 0 m distancë. Dritaret dhe ballkonet tona janë të kthyer kah ky lokacion.

Nëse këtu ndërtohet një objekt me bodrum, katin përdhese dhe 5 kate, që është në lartësinë identike me ndërtesën ton, do të:

- mbyllet tërësisht pamja,
- rrezet e diellit nuk do depërtojnë aspak,
- rrezikohen themelet e ndërtesës ton,
- cenohet në tërësi jetesa normale dhe ambienti ekologjik.

Përveç kësaj, do të citojmë nenin 18.par.1. të Ligjit mbi Ndërtim nr.04/L-110, për përcaktimin e kushteve ndërtimore, sipas së cilit:

"Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor."

Nga kjo dispozitë del se një ndërtim eventual i këtillë qenka në kundërshtim të plotë me ligjin.

Jemi të bindur se nuk do të lejoni një ndërtim kundërligjor i cili për ne do të ishte me pasoja të papërbalueshme të cilat më i lartë i cekëm.

Ju lutemi të konfirmoni pranimin e këtij kundërshtimi të dërguar me e-mail.

Ne do të përcjellim vendosjen e këtij kundërshtimi në web faqen e Komunës, ashtu siç na informuat se do të veproni në bazë të nenit 13. të Udhëzimit administrativ 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje ndërtimi për kategorinë I dhe II.

Në Prishtinë,

Më 28.06.2021.

Me respekt,

Nesrin Lushta,

Lumnije Tahiri-Bullatovci

Alltën Murseli,

Lavdie Mulolli,

Esmë Zahiti

Mihane Zogjani

Isa Lahi

Astrit Ukimeri

